



Dalës Arinena

Nr. -1- 149
Br.

Data 26.09.2018
Datum

OBILIĆ-OBILIĆ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12,14.2 ,17 pika c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 9 pika 1 dh 2 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, neni 18.2, të Rregullores nr.23/2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës si dhe neni 44.1 dhe 47.3 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 të datës 25.04.2016, dhe neni 39 i Rregullorës së Punës së Kuvendit nr.I-95,dt.29.06.2018, raporti përfundimtar i komisionit vlerësues me nr : I-115 ,dt.08.08.2018, dhe përgjigjeja në ankesë , Komisioni i Ankesave për Dhënie e Pronës Komunale në Shfrytëzim me nr.I-22646 të datës 28.08.2018 , Kërkesa e MAPL-së për rishqyrtim të Aktit të Kuvendit të Komunës së Obiliqit (të Vendimi Nr-I-129) me date 14/09/2018.Nr 020-130/3 .

Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajture me date 26.09.2018 mori këtë:

VENDIM

PËRFUNDIMTAR PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË OBILIQIT NË ZONËN KADASTRALE NË OBILIQ

I

Miratohet Vendim për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës , në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit "Agro Kor "SH.P.K

II

Sipas pikes I të këtij vendimi :

1. " Agro Kor "SH.P.K është shfrytëzues i pronave të paluajtshme të Komunës
2. Pronat e Komunës gjenden në zonën kadastrale Obiliq , ngastrat kadastrale: P-72614055-01790-28 sipërfaqja 1891 m², P-72614055-01790-30 sipërfaqja 1004 m² dhe P-72614055-01790-11 sipërfaqja 4502 m² ZK Obiliq, në sipërfaqe total prej 7397 m² bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme
3. Shfrytëzimi i pronave do të jetë për 99 vjet nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi ,pas përfundit te ketij afati pronat i kthehet titullarit .
4. Në pronën e paluajtshme të Komunës do të ndërtohet objekti për nevoja të " Agro Kor " SH.P.K

III

Dhënia në shrytëzim e pronave të paluajtëshme të cekur në pikën II , bëhet me kompenzim (sipas Komisionit Vlerësues Për Dhënie e Pronës Komunale në Shrytëzim , bazuarë në ofertën ekonomikisht më të favorshme , raporti me nr I-115,datë:08/08/2018)

IV

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë , të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shrytëzuesit të pronave të paluajtshme të Komunës

V

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillim

VI

Obligohet Drejtoria e Planifikimit Urban , Kadastër dhe Pronë që pas përfundimit të zbatimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës të regjistrojnë në librat kadastral si prona të dhëna në shfrytëzim për periudhë afatgjatë.


VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

Kuvendi i Komunës së Obiliqit
Nr. I- 149 - , më 26 Shtator 2018

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Kryesuesit
- Nënkryetarit
- MAPL
- Palës
- Anëtarëve të Kuvendit
- Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri





Udhëzimi

Nr. 1-129

Data

31.08.2018

OBJEKT - ANKESË



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obiliq - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12,14.2 ,17 pika e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 9 pika 1 dh 2 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, neni 18.2, të Rregullores nr.23/2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës si dhe neni 44.1 dhe 47.3 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.1-34 të datës 25.04.2016, dhe neni 39 i Rregullorës së Punës së Kuvendit nr.1-95,dt.29.06.2018, raporti përfundimtar i komisionit vlerësues me nr : 1-115 ,dt.08.08.2018, dhe përgjigjeja në ankesë , Komisioni i Ankesave për Dhënie e Pronës Komunale në Shfrytëzim me nr.1-22646 të datës 28.08.2018 ,
Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajturë me date 31.08.2018 mori këtë:

VENDIM

PËRFUNDIMTAR PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË OBILIQIT NË ZONËN KADASTRALE NË OBILIQ

I

Miratohet Vendim për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës , në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit "Agro Kor "SH.P.K

II

Sipas pikës I të këtij vendimi :

1. " Agro Kor "SH.P.K është shfrytëzues i pronave të paluajtshme të Komunës
2. Pronat e Komunës gjenden në zonën kadastrale Obiliq , ngastrat kadastrale: P-72614055-01790-28 sipërfaqja 1891 m², P-72614055-01790-30 sipërfaqja 1004 m² dhe P-72614055-01790-11 sipërfaqja 4502 m² ZK Obiliq, në sipërfaqe total prej 7397 m² bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme
3. Shfrytëzimi i pronave do të jetë për 99 vjet nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi ,pas përfundit të këtij afati pronat i kthehet titullarit .
4. Në pronën e paluajtshme të Komunës do të ndërtohet objekti për nevoja të " Agro Kor " SH.P.K

III

Dhënia në shrytëzim e pronave të paluajtshme të cekur në pikën II, bëhet me kompenzim (sipas RREGULLORES PËR TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE)

IV

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë , të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shrytëzuesit të pronave të paluajtshme të Komunës

V

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillim

VI

Obligohet Drejtoria e Planifikimit Urban , Kadastër dhe Pronë që pas përfundimit të zbatimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës të regjistrojnë në librat kadastral si prona të dhëna në shfrytëzim për periudhë afatgjatë.

VII


Ky vendim hyi në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

Kuvendi i Komunës së Obiliqit
Nr. I-123 - , më 31 Gusht 2018

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Kryesuesit
- Nënkryetarit
- MAPL
- Palës
- Anëtarëve të Kuvendit
- Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Burim Gërguri





Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit
Cc:	Burim Gërguri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit
Përmes:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Nga:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së
Lënda:	Xhevat Tafa, U.d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL Kërkesë për rishqyrtimin e Aktit të Kuvendit të Komunës së Obiliqit
Lloji i aktit	Vendim

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 1-129 përfundimtar për dhënien në shfrytëzim të pronës së Paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale Obiliq
I miratuar më datë: 31.08.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.09.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendimi Nr. 1-129 përfundimtar për dhënien në shfrytëzim të pronës së Paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale Obiliq.	Ky vendim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 04/L-144, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës përkatësisht Nenin 9.1 të këtij ligji si dhe nenin 18.2 të Rregullores (QRK) Nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës pasi që në procesin e votimit ky vendim është miratuar me 9 vota për. Në rastin konkret vendimi miratohet me së paku 11 vota për, nga gjithsejtë 21 anëtarët e kuvendit të komunës së Obiliqit.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal *kërkon* nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së Obiliqit, që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.